

URDHËR
Nr. 347, datë 7.6.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 438, DATË 7.10.2008, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘MBI KUSHTET E SHËNDETIT PUBLIK DHE SHËNDETIT TË KAFSHËVE, TË CERTIFIKATAVE TË QUMËSHTIT LËNDË E PARË DHE TË PRODUKTEVE ME BAZË QUMËSHTI PËR KONSUM HUMAN””, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 438, datë 7.10.2008, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi kushtet e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve, të certifikatave të qumështit lëndë e parë dhe të produkteve me bazë qumështi për konsum human””, të ndryshuar, bëhet ndryshimi më këtë përmbajtje:

a) Në listën e vendeve të treta ose pjesë të autorizuara të tyre, sipas tabelës në shtojcën që i bashkëlidhet këtij urdhri, dhe është pjesë përbërëse e tij, shtohet me të dhënat si më poshtë:

Kodi ISO i vendit të tretë	Vendi i tretë ose pjesë të tij	Kolona A	Kolona B	Kolona C
MD	Moldavi	0	0	+

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca